

Vendim nr. 219 datë 15.09.2025

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtarë, në datën 15.09.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (D) 2025 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **DENIS SELIMI**
EDIT SELIMI

OBJEKTI: **Rihapja e procesit gjyqësor kushtetues.**
Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2015-3960 (492), datë 25.11.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: **Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*);**
nenet 71, 71/a, pika 1, shkronja “b” dhe 71/c, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit janë trashëgimtarë testamentarë të një prej trashëgimtareve ligjore të një subjekti të shpronësuar, të cilit në vitin 2000 i është njohur pronësia mbi një shtëpi banimi dykatëshe, si dhe i është kthyer sipërfaqja e truallit prej 600 m², mbi të cilin është ndërtuar banesa.

Trualli dhe ndërtesa përpara vitit 2000 kanë qenë pronë shtetërore në administrim nga Ndërmarrja Kombëtare e Banesave, e dhënë me qira te persona të tretë.

2. Me pretendimin se prona nuk ka qenë e subjektit të shpronësuar, personat e tretë e kanë kundërshtuar vendimin për kthimin e pronës në rrugë gjyqësore. Pas rishqyrtimit të çështjes, gjykata e shkallës së parë ka vendosur pranimin e padisë, ndërsa gjykata e apelit e ka rrëzuar atë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-3960 (492), datë 25.11.2015, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

3. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kushtetues individual trashëgimtarët ligjorë të subjektit të shpronësuar, me pretendimin se u është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, në aspektet e së drejtës së aksesit në gjykatë, parimit të sigurisë juridike, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), me vendimin nr. 147, datë 09.06.2017 (*vendimi nr. 147/2017*), ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me argumentin se pretendimet janë haptazi të pabazuara, në kuptim të nenit 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577/2000.

4. Pas kësaj, në datën 13.02.2018 kërkuesit kanë paraqitur ankim kushtetues individual me objekt sërish shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 00-2015-3960 (492), datë 25.11.2015 të Gjykatës së Lartë. Pas shqyrtimit paraprak, Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 70, datë 30.05.2018 (*vendimi nr. 70/2018*), ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me argumentin se kërkuesit ndonëse legjitimohen *ratione personae*, nuk legjitimohen *ratione temporis*, sepse kërkesa është paraqitur jashtë afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika “b”, i ligjit nr. 8577/2000. Sipas Kolegjit, kërkuesit nuk kanë paraqitur asnjë arsye në lidhje me momentin e marrjes dijeni dhe njohjes me arsytimin e vendimit të kundërshtuar, megjithëse kanë pretenduar se kanë marrë dijeni në datën 18.10.2017, duke e vërtetuar me siglimin e bërë nga administrata gjyqësore e Gjykatës së Lartë (*shih paragrafin 13 të vendimit nr. 70, datë 30.05.2018 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në vijim, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), e cila ka regjistruar kërkesën nr. 57542/18 për çështjen “*Selimi kundër Shqipërisë*”. Me vendimin e datës 14.01.2025, GJEDNJ-ja ka konkluduar se është shkelur neni 6 § 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) në lidhje me të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, pasi afati 4-mujor për paraqitjen e ankesës kushtetuese ishte llogaritur nga data kur ishte shpallur vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë dhe jo nga data kur u ishte dorëzuar kërkuesve.

Sipas GJEDNJ-së, referuar gjetjeve në lidhje me të drejtën e kërkesve për t'iu drejtuar Gjykatës, sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ-së, ata tashmë kanë një mundësi që të kërkojnë rihapjen e procedurave pranë asaj gjykate (*shih paragrafin 18 të vendimit të GJEDNJ-së*). Vendimi i GJEDNJ-së është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 32, datë 18.02.2025 dhe ka hyrë në fuqi në datën 18.02.2025.

6. Pas dhënies së vendimit të GJEDNJ-së, kërkesit i janë drejtuar sërish Gjykatës me kërkesën sipas objektit, fillimisht në datën 09.06.2025. Kërkesa, pasi është plotësuar me aktet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 19.06.2025.

7. Në datën 30.07.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkesve për rihapjen e procesit dhe kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kolegji ka arsyetuar se kërkesit legjitimohen në kërkimin e tyre për rihapjen e procesit dhe kërkesa plotëson kushtet ligjore për t'iu nënshtruar shqyrtimit paraprak: kërkesit kanë qenë palë në procesin e zhvilluar në Gjykatë, për të cilin Kolegji ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim dhe për të është zhvilluar procesi në GJEDNJ; kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor; përmbajtja dhe pretendimet janë me natyrë kushtetuese dhe hyjnë në kompetencën e Gjykatës.

II

Pretendimet e kërkesve

8. **Kërkesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se Gjykata e Lartë u ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në aspektet e mëposhtme:

8.1. *E drejta për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi gjyqtarja, që ka kryesuar Kolegjin Civil që ka gjykuar çështjen, është dënuar për veprën penale të korrupsionit për një çështje të ngjashme të lidhur me pronat. Për rrjedhojë, vendimi i kundërshtuar është i njollosur dhe duhet rigjykuar. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk ka vepruar si gjykatë ligji, por si gjykatë fakti, pasi e ka gjykuar në themel çështjen, ka vlerësuar ndryshe provat dhe ka rrëzuar aktin e ekspertimit.

8.2. *E drejta për gjykim të drejtë*, pasi ndonëse trashëgimlënësja e tyre ka ndërruar jetë në datën e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, nuk është bërë kalimi procedural sipas ligjit. Gjykata e Lartë në mënyrë të rreme e ka konsideruar përfaqësimin e trashëgimlënësës së kërkesve nga avokati T.J.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimimin e kërkesve

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitetit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuuesit. Në këtë drejtim, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

11. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuuesit kanë ngritur pretendime në drejtim të cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në aspektet e së drejtës për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe për gjykim të drejtë.

12. Pretendimin për cenimin e së drejtës për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj, kërkuuesit e kanë mbështetur në argumentin se kryesuesja e trupit gjykues është dënuar për veprën penale të korrupsionit për një çështje të ngjashme, ndaj kjo gjyqtare, sipas tyre, blihet dhe ndikohet për çështje që kanë të bëjnë me prona, për rrjedhojë çështja e tyre duhet rigjykuar. Kërkuuesit në kërkesën e paraqitur në datën 09.06.2025 kanë shtuar edhe argumente të tjera që nuk kanë qenë të shprehura në kërkesën e tyre të datës 13.02.2018 dhe që lidhen me pretendimin se Gjykata e Lartë

nuk ka vepruar si gjykatë ligji, por si gjykatë fakti, duke e gjykuar në themel çështjen dhe se ajo ka vlerësuar ndryshe provat dhe ka rrëzuar aktin e ekspertimit.

13. Në lidhje me këtë pretendim, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren, së pari, se dënimi penal i gjyqtarës për sjellje që nuk kanë të bëjnë me çështjen e kërkuesve, nuk përbën argument të mjaftueshëm për të vënë në dyshim rregullsinë e procesit gjyqësor të tyre. Në këtë pikë, Mbledhja e Gjyqtarëve thekson se në procedimin penal, bazuar në parimin e ligjshmërisë, përgjegjësia penale i referohet një sjelljeje konkrete të paligjshme penalisht dhe nuk shërben për të karakterizuar të gjithë veprimtarinë e individit të dënuar. Së dyti, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se Gjykata e Lartë ka disponuar mbi të njëjta prova dhe fakte të cilat janë marrë në shqyrtim nga gjykatat e faktit dhe si gjykatë e ligjit ka kontrolluar ligjshmërinë e vendimmarrjeve të tyre. Fakti që ajo ka konkluduar në disfavor të kërkuesve nuk përbën tejkalim të kompetencave të saj. Nga ana tjetër, këto argumente kanë gjetur trajtim edhe në vendimin nr. 147/2017 të Kolegjit, për rrjedhojë pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj nuk mund të merret në shqyrtim.

14. Për sa i takon pretendimit për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë, kërkuesit kanë argumentuar se Gjykata e Lartë ka cenuar dispozitat ligjore procedurale, pasi ka vazhduar gjykimin, ndonëse trashëgimlënësja kishte ndërruar jetë në datën e gjykimit të çështjes.

15. Gjykata ka pohuar se detyrë e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në rastin konkret, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se trashëgimlënësja e kërkuesve ka ndërruar jetë në datën 17.10.2013, kurse gjykimi në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në seancë gjyqësore pas më shumë se dy vjetëve, në datën 25.11.2015. Ndërkohë nuk rezulton që kërkuesit të kenë paraqitur ndonjë akt përmes të cilit të kenë njoftuar Gjykatën e Lartë lidhur me situatën e trashëgimlënësës. Po kështu, nuk konstatohet që ndonjë nga palët të ketë ngritur gjatë gjykimit në seancë gjyqësore në Gjykatën e Lartë aktin e (pa)rregullsisë në krijimin e ndërgjyqësisë për shkak se njëri prej tyre ka ndërruar jetë. Nga ana tjetër, nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Lartë

rezulton se përkrah emrit të trashëgimlënësës është vendosur shënimi “në mungesë” dhe se palët e paditura janë përfaqësuar nga avokati T.J. Ndërsa në përmbajtjen e vendimit të gjykatës së apelit trashëgimlënësja është përfaqësuar nga njëri prej kërkuesve (Denis Selimi), kurse palët e tjera të paditura, familjarë të trashëgimlënësës janë përfaqësuar nga avokati T.J. Ky i fundit ka qenë përfaqësues i tyre edhe në ankimin kushtetues të paraqitur në vitin 2017, për të cilin Kolegji i Gjykatës ka dhënë vendimin nr. 147/2017. Në këtë situatë, argumentet e kërkuesve nuk janë të mjaftueshme për të vënë në dyshim rregullsinë e procesit, për rrjedhojë pretendimi i tyre për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë është haptazi i pabazuar.

17. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuesve nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.